

STATUT I SHOQERISE
“ ELECTRIC TAXI VLORE ” SH.P.K

Ky statut do te konsiderohet se inkorporon dhe / ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot me date 12.11.2024 personi i meposhtem:

Erjon Petanaj, i biri i **Gezimit**, i datëlindjes 31.05.1983 lindur dhe banues në Vlorë, me adresë Rr. Nermin Vlorë Falaski, ndertesa Nr.48, H.1,9402 Vlorë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimin (ID Card) Nr. I 30531181 V.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “ dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratova kete statut si vijon:

Ne kete statut:

- “Ligji eshte Ligji 9901 /2008 “PerTregtaret dhe Shoqerite tregtare”, i ndryshuar:
- “ Statuti” eshte ky Statut i Shoqerise

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesi


Sot me date 12.11.2024 une themeluesi i mesiperm, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin dhe emertimin tregtar **Electric Taxi Vlore” SH.P.K**

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryej aktivitetin e meposhtem:

- **Sherbime ne fushen e transportit te udhetareve, sherbim taksi e radio-taksi, per te gjithë mjetet e taksive.**
- **Sherbime taksi per publikun si brenda territorit te Shqiperise dhe jashte saj. Transporti urban dhe interurban ne funksion te sherbimit Taksi te udhetareve, ne perputhje me cdo ligj te zbatueshem dhe rregullore te fushes perkatese.**
- **Tregtim blerje dhe shitje automjetesh. Shoqeria mund te kryej dhe aktivitete te tjera, te marre pjese ne sipermarrje te tjera brenda dhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.**



- Kryerja e cdo veprimtarie tjeter tregtare, qe mund te realizohet nga nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar sipas ligjit shqiptar.
- Shoqeria Electric Taxi Vlore " sh.p.k ka te drejte te krijojë filiale te saj brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që të çmohet e arsyeshme prej saj me aprovimin e organeve kompetente.

Ne funksion te qellime te mesiperme Shoqeria mund te hyje ne tregje dhe operacione te ndryshme tregtare, te zoteroj pasuri te luajshme e te paluajshme dhe / ose pjesemarrje ne shoqeri te tjera tregtare.

Neni 3 Kohezgjatja

Kohezgjatja eshoqerise do te jete e pacaktuar dhe / ose e pakufizuar.

Neni 4 Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Shqiperi, Vlore, Njesia administrative Nr.2, rruga "Nermin Vlora Falaski", Nd. 48, H.1, 9402 Vlore.

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çel dege dhe/ ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

Kreu II Kapitali Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte ALL 100 000 (njqind mije leke). Pjesemarrja e themelueseve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin si me poshte:

- 1- Ortaku themelues z. Erjon Petanaj zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100 000 (njqind mije leke) qe perbene 100% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut eshte ne para dhe do te shlyhet prej tij menjehere me themelimin e shoqerise.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimevete pjeseve te kapitalit themeltar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kopetente e nje Audituesi Ligjor per keto kontribute sipas kerkeses seadministratorit.

Ne asnje rast shumicanuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakeve ecila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkon per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme nepermjet ortakeve. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asamblene e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asamblene e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:


- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve,
- d) Emerimin e shkarkimin e likujdueseve dhe te Audituesit-ve Ligjore,
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike.
- dh) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
 - e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ,
 - E) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit,
 - f) pjestimimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
 - g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve ,
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise ,
 - h) miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese,
 - i) shperndarjen e fitimeve vjetore ,
 - j) ceshtjete tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeterapo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund teveproj si perfaqesues i ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme.

Autorizimi mund te jepetvetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshine edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9



Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjetpostes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazhelektronik duhet te permbaj vendin, daten, oren e mbledhjesdhe rendin e dites e tu dergohet te gjithë ortakeve jo me vone se 7 dite perpara datesse parashikuarper mbledhjen e asamblese.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithëortaket jane dakord, per temarrrë vendime, pavaresisht paregullësisë.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendos per ceshtje te cilat kerkojne shu,ice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ajo mund te marr vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo mjete elektronike, sipas parashkimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve

Asambleja e Pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja epergjithshme vendos me shumice votash per ceshtje te tjera si:

-percaktimi i politikave tregtare te shoqerise, emerimin e administratoreve, emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te audituesve ligjore,

-percaktimin e shperblimeve,

-mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregatre nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,

-perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,

-miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.


Cdo ndryshim i statutit duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroj te drejten e votes nese Asambleja e Pergjithshme merr vendim per:

-vleresimin e veprimtarise se tij,



- shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
- ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria,
- dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi ashtu si edhe ortaku te cilin perfaqeson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e Pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte riprteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Personat e meposhtem caktohen si administratore te pare te shoqerise per nje mandat 5 vjecar emerimi deri me 12.11.2029:

- **Z. Erjon Petanaj**, i biri i Gezimit, i datelindjes 31.05.1983 lindur dhe banues ne Vlorë, me adresë Rr. Nermin Vlora Falaski, banese nr.999, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimin (ID Card) Nr. I 30531181 V.

Neni 14


Kompetencat e administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjithaveprimet e adminstrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e pergjithshme,
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare,
- c) kujdesen per mbajtjen te sakte e te rregullte te dokumenteve dhe librave kontabel te shoqerise,
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise seveprimtarise, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se pergjithshme per miratim,
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit,
- e) raportojne perpara Asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare,
- ë) kryejne detyra tetjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim,
- shoqeria propozon te shese apo te disponoj ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % e aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat financiare te certifikuara,



-shoqeria brenda dy viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te blej nga nje ortak pasuri qe kane vlere me te madhe se 5% e asetëve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat financiare te certifikuara,

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoj administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pavec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

a) te kryej detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis,

b) te ushtroj kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita,

c) te vleresoj me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim,


ç) te parandaloj dhe menjanoj rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise,

d) te ushtroj detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim a mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratori vepron ne kundersizim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave nje dhe dy te ketij neni eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qerrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te paregullta. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

Ne menyre te vecante por pa u kufizuar ne to administratori eshte i detyruar ti shperbleje shoqerise dqemet e shkatuara nese ne kundersizim me dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" kryen veprimet e meposhteme:



- U kthen ortakeve kontributet
- U paguan ortakeve interesa ose dividente
- U shperndan aktivet shoqerise
- Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare ku ne baze te gjendjes financiare duhet te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet
- Jep kredi

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit ortaket individualisht ose se bashku kane te drejte te ngrenepadi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte tendjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin fionnaciari nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkesepadise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Kreu IV

Viti financiar-Audituesi ligjor

Neni 16

Viti financiar

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Audituesi ligjor

Audituesi ligjor ka per detyre qe te kontrolloj te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit audituesi ligjor pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te vilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqes e dorezoj ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

Kreu V

Prishj-Riorganizimi i shoqerise

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- me vendim te Asamblese se Ortakeve,
- me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit Nr.9723/2007,



-me vendim te gjykates.

Ne kete rast ortaket marrin vendime me shkrimne te cilin parashikojne menyren e likudimit te shoqeriseduke caktuar 1 apo disa likuidatore duke shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidator dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe jane emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqerise dhe bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme, Asamblese se ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjit Nr,9901, date 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodi Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Repubilken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te lind midis Shoqerise dhe te treteve, kompetente do jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt u lexua, u kuptua dhe u nenshkrua nga ortaku themelues si vijon:

ORTAKU I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ELECTRIC TAXI VLORE" SHPK

ERJON PETANAJ

ERTON PETANAJ
